



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1323/Prot.
11

Durrës më, 19/05/2025

VENDIM

Nr. 49 Datë 19/05 2025

**PËR
"PËR SHPALLJEN E APLIKIMEVE PËR ANËTARË PËRFAQËSUES TË STUDENTËVE
PËR MANDAT PLOTËSUES TË KOMISIONIT E PËRHERSHËM PËR MBARËVAJTJEN E
VEPRIMTARISË DHE MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT TË UNIVERSITETIT
"ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"**

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 46; të Statutit të UAMD-së; të Rregullores së UAMD-së, neni 17 pika 3 ; të Vendimit të Senatit Akademik nr.63, datë 6.11.2023; si dhe kërkesës së Kryetares së Komisionit (bashkëlidhur); në mbledhjen e tij të datës 19.05.2025, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Shpalljen e aplikimeve për anëtarë përfaqësues të studentëve për mandat plotësues të Komisionit të Përhershëm për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.
2. Kandidatët për anëtarë përfaqësues të studentëve për mandat plotësues të Komisionit të Përhershëm për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët në UAMD vetëkandidohen.
3. Aplikantët si përfaqësues të studentëve duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së Senatit Akademik dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kërkesën për Kandidim, (bashkëlidhur), shoqëruar nga të paktën 30 firma të studentëve që mbështesin kandidaturën;
 - b) Vetëdeklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale (bashkëlidhur);
 - c) Kopje të dokumentit të identifikimit.
4. Afati për dorëzimin e dokumentacionit është nga data **19.05.2025 deri në datën 23.05.2025, ora 9:00 - 14:00**, pranë sekretarisë së Senatit Akademik, zyra **302**, Currila.
5. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar, Sekretaria e Senatit Akademik pasi konfirmon të dhënat e studentëve që aplikojnë me Kryesekretaritë e Fakulteteve përkatëse, përcjellë listën për votim në Senatin Akademik.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - ✓ Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - ✓ Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit për publikim në faqen zyrtare
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

SENATIT AKADEMIK

KËRKESË PËR KANDIDIM STUDENT
KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR MBARËVAJTJEN E VEPRIMTARISË DHE
MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT TË UNIVERSITETIT

Unë i/e nënshkruar/a _____, lindur
më ___/___/___, në _____, student në vitin _____
dega _____, Fakulteti _____ paraqes kërkesën
time për të qenë anëtar i Komisionit të Përhershëm për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe
Marrëdhënieve me Studentët.

Emër, Mbiemër/ Nënshkrimi

U dorëzua sot, më datën _____, në zyrën _____, tek sekretaria e Senatit
Akademik _____, (firma)

Dokumentacioni për kandidim:

- a) Kërkesën për kandidim, e cila përmban, emrin; atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë; shprehjen e vullnetit për kandidim;
- b) Vetëdeklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
- c) Kopje të dokumentit të identifikimit;

FORMULAR VETEDEKLARIMI

Te dhënat e vetëdeklaruesit :

Mbiemri, Emri	
Atësia, Mëmësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (nje kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam :

☐ i/e padënuar ☐ i/e dënuar

DEKLARUESI

MARRESI I VETEDEKLARIMIT

Emër Mbiemër / Firmë

Emër Mbiemër / Firmë

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta

dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga

Subjekti i autorizuar

Nënshkrimi i deklaruesit autorizues

Data e nënshkrimit